

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

Ne mes te:

Autoritetit Qendror Bankar te Kosovës (“AQBK”) si entitet i autorizuar nga Misioni i Administratës se Përkohshme te Kombeve te Bashkuara ne Kosovë, përgjegjës për çështjet e sigurimit te automjeteve

Byrosë Shqiptare te Sigurimit – Tiranë (AIB) si entitet i autorizuar, përgjegjës për çështjet e sigurimit te automjeteve

(me poshtë te përmendura si “**Palët**”) sa i përket:

- Njohjes se dyanshme te Certifikatave te Sigurimit te detyruar te Auto përgjegjësisë te Palës se Trete si vërtetim për sigurimin e detyrueshëm TPL; dhe
- Procedurat për trajtimin, pagesën dhe kompensimin e sigurimeve te detyrueshëm te dëmeve TPL

I. Definicionet

Për qëllimet e këtij Memorandumi te Mirëkuptimit (MOU), fjalët dhe shprehjet ne vijim do te kenë vetëm kuptimin e definuar me poshtë dhe asnjë tjetër:

Anëtari sigurues	Kompania e licencuar e sigurimit, e cila është anëtare e AIB-se ose IAK-ut, dhe te cilat kane siguruar automjetin i cili ka shkaktuar aksidentin ne fjalë, me ane te policës se se sigurimit te detyrueshëm te automjetit motorik
Byroja e pagesave	Byroja, qofte AIB apo IAK, te cilët janë përgjegjës për përmbushjen e obligimeve ndaj Byrosë për Trajtim, dhe tek paditësit për sa i përket pagesës te kompensimit dhe dëmtimeve ne pajtim me procedurat e këtij memorandumi.
IAK	Shoqata e Sigurimeve te Kosovës.
Byroja për Trajtime	Pala, qofte ajo AIB (apo njeri nga anëtaaret e saj te autorizuar), apo CSO e cila ka si përgjegjësi trajtimin dhe kompensimin e dëmeve sipas dispozitave te këtij Memorandumi te Mirëkuptimit dhe ligji i aplikueshëm, te cilët kërkojnë kompensim nga Anëtari Sigurues nëpërmes Byrosë se Pagesave.
CSO	Organizata për Trajtimin e Dëmeve, e cila është emëruar nga AQBK-ja qe te trajtoj si dhe te mbikëqyr kompensimin e dëmeve TPL ndërkombëtar ne Kosovë dhe është e mbikëqyrur nga AQBK-ja.

Korrespondentë

Çdo Anëtar Sigurues ose personat tjerë të emëruar nga Byroja e Pagesave me kërkesë të një apo me shumë Anëtareve Sigurues me aprovimin e Palës në të cilën personi është vendosur që të shqyrtoj trajtimin dhe kompensimin e dëmeve shkaktuar nga aksidentet që përfshinë automjetet për të cilat Anëtare(et) Sigurues në fjalë kanë lëshuar policë të sigurimit që ndodhen në atë territor.

Këshilli i Byrosë
Marrëveshja e Uniformuar
(Rregulloret e Brendshëm)

Rregullorja e Brendshëm e cila është pranuar nga Këshilli i Byrosë në Asambleenë e Përgjithshme në Rethymnou (Crete) më 30 Maj 2002 me disa ndryshime të kohe pas kohëshem.

Fondi garantues

Nënkupton fondin i cili është themeluar me ligj që mbikëqyret nga AQBK-ja në Kosovë dhe AIB në Shqipëri.

Vërtetimi mbi Sigurimin

Nënkupton një Certificate të vlefshëm të sigurimit vendor TPL për automjetet motorik përkatësisht të regjistruar në Kosovë, e lëshuar nga Anëtari Sigurues në Kosovë, ose një police valide të sigurimit vendor TPL për automjetet motorike përkatësisht të regjistruar në Shqipëri, e lëshuar nga një Anëtar Sigurues në Shqipëri.

II. NJOHJA RECIPROKE E PËRGJEGJËSISË SIGURUESE TË AUTOMJETEVE MOTORIK

1. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike të regjistruara në Kosovë, të cilët posedojnë Policën valide vendore të sigurimit TPL, mund të hyjnë dhe të udhëtojnë lirisht në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kopja e mostrës së policës TPL valide vendore të sigurimit i është bashkangjitur këtij Memorandum si Shtojca 1.

2. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike te regjistruara ne Republikën e Shqipërisë, te cilët posedojnë Certifikatën valide te zakonshme vendore te Sigurimit te Detyrueshëm te Auto përgjegjësisë, mund te hyjnë dhe te udhëtojnë lirisht neper Kosovë.
3. Secila Pale duhet ti jep Palës tjetër listën, ku janë te përfshirë emrat e te gjithë Anëtareve Sigurues, brenda 14 ditëve pas nënshkrimit te këtij Memorandumi te Mirëkuptimit, dhe pastaj për çfarëdo ndryshimi duhet te njoftoj Palën tjetër me kohë.
4. Palët pajtohen qe secila Certificate e Sigurimit, për te cilën supozohet se është lëshuar me autorizimin e Palës tjetër, do te konsiderohet si dëshmi valide e sigurimit, edhe ne qofte se ai dokument është i falsifikuar apo është lëshuar ne pajtim me Nenin 9 te Rregullores se Brendshëm.

II/1 KORRESPONDENTËT

1. Secila palë do te parashtrij kushtet sipas te cilave ajo jap, refuzon ose tërheq aprovimin e saj tek korrespondentët te cilët janë themeluar ne territorin ne te cilin janë kompetent. Megjithatë, ky aprovim duhet dhënë ne mënyre automatike kur kërkohet ne emër te anëtarit sigurues te Palës tjetër për çdo themelim te këtij anëtari sigurues ne territorin e Palës qe pranon kërkesën e siguruar me kushte qe themelimi i tillë është autorizuar ne mënyre qe te krijoj siguri ndaj përgjegjësisë civile ne lidhje me përdorimin e automjeteve motorike.
2. Vetëm Byroja e pagesave duhet te ketë autoritetin, me kërkesën e njërit nga Anëtareve Sigurues te saj, qe ti dërgoj Byrosë për Trajtime një kërkesë për aprovimin e korrespondentit i cili është themeluar ne territorin e Byrosë për Trajtime. Kjo kërkesë duhet dërguar përmes faksit apo postes elektronike dhe te mbështetur me dëshmi qe tregon se korrespondenti i propozuar e pranon aprovimin e kërkuar.
3. Byroja për Trajtime duhet te jap aprovimin ose refuzimin brenda 3 muajve nga data e pranimit te kërkesës dhe duhet t'ia njoftoj vendimin e saj dhe datën e hyrjes ne fuqi Byrosë se pagesave qe ka bere kërkesën si dhe korrespondentit te interesuar. Ne rast se nuk merret asnjë përgjigje, atëherë duhet menduar se është dhënë aprovimi dhe qe ka rezultuar ne skadimin e asaj periudhe.
4. Korrespondenti duhet te trajtoj te gjitha demet ne përshtatje me çdo dispozite ligjore ose rregullatorë te aplikueshëm ne territorin e aksidentit lidhur me përgjegjësinë, kompensimin e palëve te lënduar dhe sigurimet motorike te detyrueshëm, ne emër te Byrosë se pagesave qe e ka emëruar atë dhe ne emër te Anëtarit Sigurues qe ka bere kërkesën për aprovimin e saj, qe rrjedhin nga

aksidentet e ndodhur ne atë territor përfshire automjetet e siguruar nga siguruesi i cili kërkon aprovimin e saj.

5. Pala qe ka dhënë aprovimin e saj tek korrespondenti e njuh atë si eksklusivisht kompetent për trajtimin dhe kompensimin e dëmeve ne emër te Byrosë se pagesave dhe te Anëtarit Sigurues qe ka kërkuar aprovimin a saj. Byroja për Trajtime duhet njoftuar palët e lënduar te kësaj kompetence dhe t'ia dërgoj korrespondentit çdo njoftim lidhur me demet e tilla. Megjithatë, Byroja për Trajtime mundet, nëse ka ankesa nga Palët e treta te dëmtuar për rrjedhat e trajtimit te dëmeve te korrespondentëve, ne çdo kohe dhe pa asnjë obligim te justifikoj vendimin e saj dhe te marr përsipër trajtimin dhe kompensimin e dëmit nga korrespondenti.
6. Byroja e pagesave është përgjegjës i drejtpërdrejt për obligimin e korrespondentit ndaj palës se dëmtuar. Ky obligim duhet përmbushur brenda 15 ditësh nga njoftimi i lëshuar te Byrosë për Trajtime.
7. Për sa u përket dispozitave te Nenit 3, te Kapitullit IV, korrespondenti ka te drejt qe te pajtohet me Anëtarin Sigurues i cili ka kërkuar aprovimin e kushteve për kompensimin e shumes se paguar tek palët e dëmtuar dhe metodën për llogaritjen e trajtimit te tarifës por marrëveshja e tille megjithatë, nuk do te jete e detyrueshëm ndaj asnjë Palë.
Nëse korrespondenti nuk ka mundësi qe te siguroj kompensimin e pagesës paraprake qe ka bere ne përputhje me kushtet e parashtruar te Nenin 3, Kapitullit IV, ne emër te Anëtarit Sigurues i cili e ka kërkuar aprovimin e saj, atëherë ajo do te rikompensohet nga Byroja e pagesës e cila e ka emëruar atë.
8. Kur Byroja e pagesave merr njoftimin se një nga Anëtarët e saj Sigurues ka vendosur qe te shkarkoj një nga korrespondentët, atëherë ajo duhet te njoftoj menjëherë Byronë për Trajtime qe aprovimi është pranuar. Kjo shkalle duhet te jete liri e përcaktimit te datës ne te cilën aprovohet ndërprerja e veprimit te saj.
9. Kur Byroja për Trajtime e cila ka pranuar aprovimin e korrespondentit vendos qe ta tërheq atë ose informohet se korrespondenti dëshiron qe ti aprovohet tërheqja, ajo atëherë duhet te informoj menjëherë Byronë e pagesave qe ka dërguar kërkesën për aprovimin e korrespondentit. Ajo gjithashtu duhet te informoj Byronë e pagesave lidhur me datën e tërheqjes efektive nga ana e korrespondentit ose datën ne te cilën aprovohet ndërprerja e veprimit te saj.

III. TRAJTIMI DHE PAGESA E KËRKESAVE PËR ZHDËMTIM

1. Secila Pale do te trajtoj dhe do te paguaj kërkesat për zhdëmtim qe i janë adresuar nga Pala tjetër ne kuadër te këtij MOU, ne pajtim me Kapitullin IV te këtij Memorandumi, respektivisht ne interes te Anëtarit Sigurues sikur ai te ketë lëshuar Certifikatën e Sigurimit dhe ne përshtatje me dispozitat ligjore ne fuqi brenda territorit te vet.

2. Byroja për Trajtime mund te konsultohet me Byronë e Pagesave para se te ndërmarr masa përfundimtare lidhur me kompensimin e dëmeve, por nuk është e obliguar qe te bej një gjë te tille. Byroja për Trajtime është kompetente për sa i përket te gjitha çështjeve qe kane te bëjnë me interpretimin e dispozitave ligjore ne fuqi dhe trajtimin e dëmeve ne territorin e vet.

3. Ky MOU, do te përfshij raportimin, trajtimin dhe pagesat e kërkesave për zhdëmtim për lëndime personale si dhe për humbje apo dëmtim te pasurisë:
 - a) qe kane ndodhur si pasoje e ndonjë aksidenti ne Republikën e Shqipërisë, te shkaktuar nga automjetet e siguruara, te regjistruara ne Kosovë; ose
 - b) qe kane ndodhur si pasoje e ndonjë aksidenti ne Kosovë, te shkaktuar nga automjetet e siguruara, te regjistruara ne Republikën e Shqipërisë.

4. Ne rast te aksidentit, Byrotë për Trajtime, janë te obliguara qe menjëherë te njoftojnë njëra-tjetrën, për periudhën jo me gjate se 7 dite pasi te jete raportuar zhdëmtimi.

5. Pasi te jete paguar kompensimi, Byroja për Trajtime është e obliguar ti dërgoj Byrosë për Pagesa, te gjitha dokumentet e nevojshme për te justifikuar pagesën, duke përfshire edhe raportin e policisë, i cili përmban te dhënat mbi pjesëmarrësit ne aksidentin e tille, fotografitë e automjetit te dëmtuar, ekspertizën profesionale ne vlerësimin e demit, si dhe Certifikatën e sigurimit, apo kur kjo nuk është e mundur, informata lidhur me certifikatën e sigurimit te automjeteve motorike te lëshuar nga një Anëtar Sigurues, se bashku me konfirmimin për mbulimin e sigurimit, si dhe “Formularin e Pagesës” ne te cilën evidentohet kompensimi i demit.

6. Ne rast te sigurimit- demit nga ana e kompetencës se korrespondentit sa me pare qe ti behet e ditur Byrosë për Trajtime, njoftimi përkatësisht kërkesa për zhdëmtim do ti adresohet korrespondentit lidhur me procedurat e mëtejshme pa vonesë.

- 6.1 Korrespondenti duhet ti trajtoj demet ne emër te siguruesit përgjegjës ne përshtatje me çdo provizion ligjor ose rregullator qe është i aplikueshëm ne territorin e aksidentit lidhur me përgjegjësitë, kompensimet dhe sigurimet e detyrueshëm TPL te automjeteve motorike.
- 6.2 Korrespondenti ka për detyre përmbushjen e obligimeve ndaj dëmtimeve te Palës se Trete te pagesës se drejtuar për trajtimin e dëmeve ne kushtet e njëjta si te rasteve te sigurimit – ku kërkesa për zhdëmtim kompensohet nga Byroja për Trajtime. Byroja e pagesave për Anëtarët Sigurues do te jetë ekskluzivisht përgjegjës për çdo veprim, ose aktivitet te korrespondentit si dhe përmbushjen e obligimeve për zhdëmtimin e shkaktuar nga demet e trajtuar.
- 6.3 Korrespondenti është i obliguar ti raportoj Byrosë për Trajtime çdo muaj për demet e parashtruar, te kompensuar te jashtëzakonshme ose te rezervuar.
- 6.4 Ne rast te daljes ne gjyq Palët pajtohen dhe pranojnë “ligjshmëri pasive” solidare te Anëtareve Sigurues dhe Byrosë se Pagesave.

IV. KOMPENSIMI

1. Byroja për Pagesa te cilës pale, është e obliguar t’ia kompensoj Byrosë për Trajtime te Palës tjetër, shumen e tërësishme te paguar nga Byroja për Trajtime e palës tjetër, ne lidhje me kërkesën për zhdëmtim, sipas përkufizimeve te këtij MOU, si dhe shpenzimet e trajtimit dhe te gjitha shpenzimet e tjera te shkaktuara gjatë trajtimit te asaj kërkesë për zhdëmtim, siç paraqitet ne paragrafin 3 ne vijim.
2. Tarifat e trajtimit te Byrosë për Trajtime, llogariten sipas përpjesës 15% te shumës totale te kompensimit, me kusht qe tarifa minimale e trajtimit te jetë 200.00 euro, ndërsa ajo maksimale 3,500.00 euro.
3. Shpenzimet e tjera qe paraqiten gjate trajtimit te demit, te përfshira ne shpenzimet e trajtimit, do te paguhen ne pajtim me procedurat e Marrëveshjes Uniforme te Këshillit te Byrove.
4. Gjatë këmbimit te Euros dhe Lekut Shqiptar, për te gjitha pagesat ne pajtim me ketë MOU, do te merret parasysh kursi zyrtar i këmbimit i caktuar nga Banka Popullore e Republikës se Shqipërisë, ne ditën kur kërkesa për kompensim nga Byroja për Trajtime i është dërguar Byrosë për Pagesa.

5. Pas kompletimit të trajtimit të kërkesës për zhdëmtim, dhe sigurimit të “Formularit të pagesës” të nënshkruar nga ana e paraqitësit të kërkesës dhe kur ekzekutohet pagesa e kërkesës për zhdëmtim:

a) Për kërkesat për zhdëmtim që janë si rrjedhojë e aksidenteve në Republikën e Shqipërisë, dhe të trajtuar nga një anëtar i AIB, AIB do të njoftoj IAK-un në lidhje me trajtimin dhe pagesën e kërkesës për zhdëmtim, së bashku me llogaritjen e demit për secilin rast, siç parashihet me Nenin III. 4, më lartë.

AQBK-ja duhet ta udhëzoj IAK-un që t’ia dërgoj Organizatës për Trajtimin e Dëmeve (CSO) kopjen e tërë dokumentacionit që ka të bëjë me rastin, menjëherë pasi të jetë informuar për çështjen paraprake dhe pa vonesë, brenda afatit prej 60 ditësh dhe nga data e dërgimit të kërkesës të ekzekutoj pagesën për kompensim tek AIB.

Nëse kërkesa për kompensim nuk zgjidhet brenda 60 ditëve, filluar nga data kur është paraqitur kërkesa, AQBK-ja do ta udhëzoj IAK-un që t’ia paguaj AIB-it kamatën gjyqësore në shkallë prej 12% në vit, duke filluar nga data e pranimit, të kërkesës për kompensim.

b) Në lidhje me kërkesat për zhdëmtim me rastin e aksidenteve në Kosovë, CSO do ta njoftoj Anëtarin Sigurues të AIB-it rreth trajtimit të kërkesës për dëmtim dhe pagesën së bashku me llogaritjen e demit për secilin rast, siç parashihet në III. 4, më lartë.

Anëtarin Sigurues të AIB-it do të paguaj kompensimin në favor të IAK-ut brenda 60 ditësh pas pranimit të kërkesës së tillë nga CSO.

Nëse kompensimi nuk kryhet plotësisht brenda afatit të përcaktuar, CSO do t’ia dërgoj një kopje përkujtimi të kompensimit Byrosë së Sigurimeve të Shqipërisë (AIB), e cila duhet të trajtoj kërkesën për kompensim brenda 30 ditësh nga pranimi i letrës përkujtuese. Nëse kërkesa nuk paguhet brenda 60 ditësh nga data kur për herë të parë është pranuar kërkesa për kompensim, AIB është e obliguar të paguaj kamatën gjyqësore në shkallë prej 12% në vit, duke filluar nga data kur për herë të parë është pranuar kërkesa për kompensim.

6. Palët në fjalë duhet të përpiqen që me marrëveshje reciproke (miqësisht) të zgjedhin të gjitha kontekstet në mes tyre. (fjalë të shtuar).
Në rast të çfarëdo konteksti në mes të Palëve, “një Organ Arbitrazhi” duhet të definohet, së vendimet e të cilit do të jenë të detyrueshme për Palët. Organi i Arbitrazhit do të ketë kompetencat për të caktuar shpenzimet e arbitrazhit dhe kush do të barte ato shpenzime.

V. FONDI GARANTUES

1. Secila pale pajtohet qe ne baza te reciprocitetit, ne rast te dëmtimit apo humbjes qe mbulohet nga Fondi Garantues i tyre, t'u siguroj mbrojtje dhe mbështetje te njëjte, personave qe janë me banim te përhershëm ne territorin e palës tjetër ashtu siç u siguron personave me banim te përhershëm ne territorin e vet.
2. Personat qe janë banor te Kosovës te cilët bartin dëmtimin apo humbjen sipas paragrafit 1 me lartë, gjate qëndrimit ne territorin e Shqipërisë kane te drejt qe t'ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim Fondit Garantues te administruar nga AIB, sipas te njëjtave kushte qe vlejné për banoret e Shqipërisë. Personat qe janë banor te Shqipërisë, te cilët bartin dëmtimin apo humbjen sipas paragrafit 1 me lartë, gjate qëndrimit ne territorin e Kosovës, kane te drejt qe t'ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim Fondit Garantues te administruar nga AQBK, sipas te njëjtave kushte qe vlejné për banoret e Kosovës.

VI. TE NDRYSHME

1. Asgjë ne apo lidhur me ketë MOU nuk do te konsiderohet e injoruar, e shprehur apo e nënkuptuar, mbi privilegjet dhe përjashtimet e përcaktuara nga Kombet e Bashkuara, përfshirë UNMIK-un.
2. Palët do te bëjnë përpjekje te mëdha për te zgjidhur miqësisht çfarëdo mospajtimi qe vije nga ky MOU.

VII. HYRJA NE FUQI DHE ANULIMI

3. Ky MOU do te hy ne fuqi më _____.
4. Validiteti i këtij MOU është i pacaktuar. Qe te dyja palët kane te drejtë për ta anuluar ketë MOU, duke e njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër, se paku ne afat prej 90 ditësh. Kur njoftimi me shkrim te jetë dërguar me postë, si date e njoftimit do te llogaritet data kur është dërguar shkresa siç është e verifikuar edhe nga vula zyrtare e postës.
5. Kërkesat për zhdëmtim me rastin e aksidenteve te cilat kane ndodhur gjatës kohës se këtij MOU, duhet te trajtohen dhe te paguhen sipas përkufizimeve te këtij MOU, edhe pas anulimit te tij.

Nënshkruar me 31 Tetor 2006

Për UNMIK-un
Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës

Michel Svetchine
Drejtori i Përgjithshëm

Nënshkruar me 31.10.06

Për Byronë Shqiptare te Sigurimit

Valbona Kaduku
Drejtor Ekzekutiv
